



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 9, datë 17.07.2020

PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATURËS SË ZOTIT PREL MARTINI, PËR SHKAK TË TËRHEQJES NGA KANDIDIMI PËR GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE SHPALLUR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATË 07.02.2018 DHE RISHPALLUR NË DATË 27.09.2019

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Fiona Papajorgji	- Anëtare
Arta Marku	- Anëtare/Relatore
Miranda Andoni	- Anëtare
Saida Dollani	- Anëtare
Ludovik Dodaj	- Anëtar
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Arjan Qafa	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

Me praninë e Avokates së Popullit, **znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësues i autorizuar i Presidentit të Republikës,
- **znj. Katrin Treska**, përfaqësuese e autorizuar e Presidentit të Republikës,
- në mungesë të përfaqësuesve të tjerë të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje,

në mbledhjen e datës 17.07.2020, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATI PËR GJYQATAR
NË GJYKATËN KUSHTETUESE:**

z. PREL MARTINI

OBJEKTI:

Tërheqje nga kandidimi për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, për plotësimin e vendit vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, **Arta Marku**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 8577/2000), Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mbarimit përpara afatit ligjor të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj.

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në përfundim të procedurës së verifikimit të kandidaturave, me vendimin nr.137, datë 22.10.2019, vendosi:

- Pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Presidentin e Republikës, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur me Dekretin nr. 10723 datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.

3. Në zbatim të vendimit nr. 137, datë 22.10.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe të nenit 125 të Kushtetutës, si dhe të pikës 1 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, Presidenti i Republikës, në datën 27.09.2019, ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mbarimit përpara afatit ligjor të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj.

4. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

5. Në vijim Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me vendimin nr. 138, datë 22.10.2019, vendosi: *“Revokimin e vendimit nr. 137, datë 22.10.2019 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Presidentin e Republikës së Shqipërisë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur me Dekretin nr. 10723 datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.”*

Vijimin e procedurave të verifikimit dhe të vlerësimit, të kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të rishpallur me Dekretin nr.11291 datë 27.09.2019 nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.”.

6. Në zbatim të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim ligji nr. 115/2016) dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2, datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019 është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

7. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar në mbledhjen e datës 05.04.2019, për vendin vakant të krijuar për anëtar të Gjykatës së Kushtetuese, nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në zbatim të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2, datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtar i Këshillit, zoti Eriol Roshi.

Për shkak të përfundimit të mandatit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (i përkohshëm) 2019, zhvillimi i procedurave të verifikimit për këtë pozicion vakant i kaloi Këshillit të Emërimeve në Drejtësi 2020, i cili në datën 15.01.2020 zhvilloi shortin manual dhe relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, Arta Marku. Sipas parashikimit të pikës 5/2, shkronja “b”, të vendimit nr. 4, datë 11.3.2019, të ndryshuar, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, relatorja Arta Marku kontrollon saktësinë dhe plotësinë e veprimeve të kryera dhe konfirmoi veprimet e deritanishme të relatorit të mëparshëm.

8. Në datën 24.10.2019, kandidati Prel Martini është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklaramentit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen kandidimit.

9. Në datat 27 dhe 30.10.2019, kandidati Prel Martini ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklaramentit dhe autorizime përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

10. Kandidati Prel Martini, në datën 08.11.2019, ka dërguar në rrugë elektronike kërkesën për heqjen dorë nga kandidimi.

11. Në thelb, në shpjegimet e tij, kandidati Prel Martini, parashtrohet se:

“Faleminderit për lajmërimin tuaj administrativ zyrtar.

Por dua t’ju lajmëroj se heq dorë nga kërkesa ime për vendin vakant të anëtarit të gjykatës kushtetuese, të Besnik Ymerit, sepse nuk më premtën koha 5 ditore për të paraqitur deklaratat dhe dokumentat e mia dhe të familjarëve të mi pranë ILDKPKI. Sepse jeta ime në punë që nga viti 1978 deri më sot përbën 43 vjet, dhe një pjesë e madhe të dokumentacionit janë djegur nga arkivat në rrugë të kundraligjshme dhe një pjesë e dokumentacionit të jetës time në punë janë djegë edhe nga legjislacioni duke mbaruar afatin e tyre ekzistues. Si për shembull është djegur dosja hetimore e pushuar të cilën pas 5 viteve digjet me ligj. Po kështu edhe afati 5 ditor, ky afat është shumë i shkurtër dhe fëmijët e mi që ndodhen jashtë shtetit me punë tash disa vite si në Suedi, Hollandë dhe Itali është e pamundur për t’i mbledhur dhe paraqitur për 5 ditë. Në këto kushte është e pamundur për të paraqitur tërë këto dokumentacione të 43 viteve punë të miat si kërkues dhe të disa viteve të bashkëfamiljarëve të mi që i kërkon ligji.

Në këto kushte unë jam i detyruar dhe tërheq kërkesën time për vendin vakant. Theksoj se legjislacioni që është bërë nga parlamenti Shqiptar për këto probleme për të paraqitur tërë këtë dokumentacion nga kandidati është në kundërshtim të plotë me legjislacionin shqiptar gjatë 25 viteve të fundit dhe është në kundërshtim me legjislacionin mbi të drejtat e njeriut dhe legjislacionin e gjykatës ndërkombëtare të drejtave të njeriut.

Në këto kushte nuk mund të bëj asnjë veprim se në Shqipëri çdo gjë është e bllokuar me këtë legjislacion.”.

12. Në zbatim të pikës 31 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar, anëtari i Këshillit relator për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datë 27.09.2019, ka njoftuar Këshillin lidhur me vullnetin e shprehur nga kandidati Prel Martini për tërheqjen nga kandidimi për këtë vend vakant, duke përgatitur dhe dërguar për shqyrtim relacionin dhe projektaktin përkatës mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të këtij kandidati.

13. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar, zv/Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 17.07.2020, ora 13 e 30, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të z. Prel Martini, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datë 27.09.2019.

14. I njëjti njoftim, së bashku me materialet e çështjes i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

15. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 17.07.2020, ora 13 e 30 dhe rendin e ditës janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

16. Njëkohësisht, për shqyrtimin në këtë mbledhje të çështjes lidhur me përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të zotit Prel Martini, për shkak të tërheqjes nga kandidimi, është njoftuar edhe vetë kandidati Prel Martini, nëpërmjet postës elektronike zyrtare, në datën 13.07.2020.

17. Në mbledhjen e Këshillit, pas relativitetit të parashtruar nga relatorja dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit.

18. Në thelb, Avokati i Popullit parashtroi se ishte dakord me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidatit, se vullneti për dorëheqje është i qartë dhe se nuk kishte asgjë për të shtuar.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

19. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke pasur parasysh dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të sipërcituara, bazuar në relacionin dhe aktet e dërguara nga anëtari i Këshillit relator i caktuar për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019, si edhe në shprehjen e vullnetit nga kandidati në shqyrtim lidhur me kandidaturën e tij, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatit Prel Martini.

20. Në pikën 1 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, parashikohet se për plotësimin e vendeve vakante që krijohen në Gjykatën Kushtetuese, Presidenti i Republikës:

“1.shpall në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit hapjen e procedurës së aplikimit. Aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 7/a paraqiten pranë Presidentit të Republikës, i cili ia dërgon ato Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.”.

21. Në zbatim të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 234 e vijues të ligjit nr. 115/2016, pas dërgimit të listës së kandidatëve që kanë shprehur interes së bashku me dokumentacionin e paraqitur, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka filluar në datën 22.10.2019 procedurën e verifikimit të kandidaturave për plotësimin e kushteve dhe kriterëve të kandidimit që parashikohen nga Kushtetuta dhe ligji.

22. Ligji nr. 8577/2000 dhe ligji nr. 115/2016 nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur rastin e tërheqjes nga kandidimi dhe mënyrën e disponimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në raste të tilla.

23. Por, nga ana tjetër, ligji nr. 115/2016, në pikën 2 të nenit 229, parashikon se:

“2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita, me vendim, miraton rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre”.

24. Bazuar në këtë detyrim dhe delegim ligjor për të miratuar, në bazë dhe për zbatim të ligjit, rregulla më të detajuara normative, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë aktin nënligjor normativ, vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar.

25. Në lidhje me rastin e tërheqjes nga kandidimi, në vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i ndryshuar, në pikat 8 dhe 31 të tij, parashikohet se:

“8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.”.

“31. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projektaktin mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.”.

26. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore dhe atyre nënligjore normative të zbatueshme në rastin e tërheqjes nga kandidimi, vlerëson të rregullt procedurën e ndjekur deri tani për verifikimin e kandidaturës së kandidatit Prel Martini. Kandidati është njoftuar rregullisht për fillimin e kësaj procedure, sipas rrugës elektronike në datë 24.10.2019.

27. Gjithashtu, nga aktet që përmban dosja e kandidimit, rezulton se kandidati Prel Martini, në datën 08.11.2019, i ka paraqitur në rrugë elektronike, me e-mail, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi kërkesën për heqjen dorë nga kandidimi. Ky njoftim gjendet në dosjen e kandidimit dhe një kopje i bashkëlidhet këtij vendimi. Vullneti për tërheqjen nga kandidimi rezulton i shprehur në mënyrë të qartë.

28. Këshilli vlerëson se shprehja e interesit dhe kandidimi për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese është një e drejtë, e cila ushtrohet nga kandidatët ekskluzivisht mbi vullnetin individual të tyre, duke respektuar procedurat, kushtet dhe kriteret e kandidimit që parashikon Kushtetuta dhe ligji.

29. Në rast se personi që kandidon, në çdo kohë e gjendje të procedurës, shpreh vullnetin për të mos vijuar më tej me kandidimin për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, atëherë nuk ka më vend të vijojnë procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës, të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tij.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikave 2 dhe 3 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikave 8 dhe 31 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të z. Prel Martini, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Prel Martini.
3. Kandidati Prel Martini ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

